

# SHOQATA E KARDIOLOGËVE TË KOSOVËS



## Gani Bajraktari

*Profesor i Mjekësisë Interne  
dhe Kardiologjisë  
Fakulteti i Mjekësisë  
Universiteti i Prishtinës*

*Specialist i Kardiologjisë Klini-  
ka e Kardiologjisë  
SHSKUK*

*Kryetar i Shoqatës së  
Kardiologëve të Kosovës*

### Kardiologjia- Kjo dashuri hyjnore

Ftesa e Revistës "MJEKU" nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të shkruar një shkrim editorial për kardiologjinë kosovare, përkatësisht për Shoqatën Nacionale të Kardiologjisë, më shkaktoi kënaqësi, emocione, por edhe vështirësi në të njëjtën kohë. Ndërkohë që menjëherë pas kësaj ftese m'u sollën në mendje shumë kujtime, ecajaket e komunitetit të mjekëve kosovarë që u kujdesen për zemrat e popullit të tyre, njëkohësisht më vuri në siklet fakti se pikërisht unë isha personi i përzgjedhur dhe i ftuar që të flas për këtë komunitet, që në secilën shoqëri moderne, por edhe në ato më pak moderne, është komunitet tejet i respektuar dhe lartë i çmuar në kupolat akademike e shtetërore. Përkundër vullnit të pashtjerrshëm krijues, brenda pak sekondash konstatova se unë nuk isha meritori për të shkruar për historinë e zhvillimit të këtij komuniteti. Mirëpo, bredhjet e mendimeve, kujtimeve, përjetimeve, kënaqësive e gëzimeve, si dhe pashmangshëm edhe hidhërimeve më demantuan për pak minuta. Këta pak minuta më çuan në konstatimin se për tri dekada me radhë, unë kam jetuar me mendje, me zemër e shpirt në organin më vital të njeriut, që mban gjallë të gjitha të tjerat e pa të cilin të gjitha të tjerat janë NUL. Pra për tri dekada unë paskam jetuar i futur thellë në zemër, herë në nyjen sinusale, aty ku fillon jeta e zemrës, herë duke kërcyer nga një qelizë e miokardit në tjerën, e më shpeshë duke vallëzuar tango në ventrikulin e majtë, për t'u rrembyer furishëm nga valët e jetës deri në harkun e aortës, të cilat pamëshirshëm më kthenin në ujëvarat e saja për të më përplasur në kuspiset e saja. Jo pak kohë kam qëndruar për këto tri dekada i strukuar në pllakat aterosklerotike, një xhungël e shpifur dhe e tmerrshme për njerëzimin, por që të shkakton një kënaqësi të pashpjegueshme për ta hulmtuar. Edhe kur luaja futboll, edhe kur isha në klub fitnesi, edhe kur drekoja apo darkoja, edhe kur vallëzoja, edhe kur meditoja, edhe kur i lutesha gjumit të më merrte, mendja më rrinte në zemër, imagjinata punonte për zemrën dhe për ata pacientë, zemrat e të cilëve kishin nevojë për ndihmën time. Këta pak minuta pas marrjes së ftesës nga Oda, m'u shfaqën përpara shumë pacientë që nuk kisha arritur t'i shpëtoja nga vdekja, e qindra të tjerë që kisha shpëtuar nga më e keqja! M'u shfaqën të freskëta fytyrat falënderuese të pacientëve që kishin parë vdekjen me sy, të cilët me lotë gëzimi shpërfaqnin mirënjohjen nga thellësia e shpirtit të tyre! Akoma besoj se nuk ka gjë më të shenjtë se të shpëtosh jetën e tjetrit! Pra, pak minuta m'u deshën për të konstatuar se profesioni që unë ushtroj për tri dekada qenka mishëruar thellë në secilën qelizë të trupit tim, për të konstatuar se kardiologjia qenka gjëja më e të cilën unë paskam bashkëjetuar më shumë se me çdo gjë tjetër, të vdekur dhe të gjallë! Në të vërtetë, unë po e doja këtë profesion, dhe jeta ime nuk paska kuptim pa kardiologjinë!

"Unë qenka i dashuruar në kardiologji! Madje kjo qenka dashuria ime më e madhe jetësore: një dashuri pa kushte e pa afat, një dashuri e përjetshme dhe e

pavdekshme", belbëzoja me vete i shtrirë në kolltukun e dhomës së ditës në banesën time, me sytë e drejtuar kah tavana, pas një dite tmerrësisht të ngarkuar me mjekimin e zemrës dhe duke mësuar studentët që do të merren me këtë profesion kaq të dashur në të ardhmen.

"Ka mundësi njeriu të dashurohet në profesion, në zanat?", pyeta veten dhe nga parahatja e shpirtit të shkencëtarit iu afrova kompjuterit për ta hulmtuar dashurinë që unë jetoja pavetëdijshëm për tri dekada. Me pak fjalë kyçe në google gjeta se paska njerëz që kanë "vuajtur" më shumë se unë nga dashuria e quajtur kardiologji. Dr. Payal Kohli, një kardiologe e mirënjohur që punon në Universitetin e Harvardit (nga fotografia duket të jetë me origjinë indiane), shpjegon në detaje ditën kur ajo ra në dashurinë e saj të parë (<https://opmed.doximity.com/articles/cardiology-my-first-love>) të quajtur kardiologji, dashuri që edhe sot e ndjek në çdo hap të jetës së saj kaq të suksesshme në njërin nga universitetet më prestigjioze në botë. Ajo përkujtonte në këtë shkrim se si kardiologjia i ishte bërë diçka hyjnore në jetën e saj.

Pa dashje, kujtimet më shpien te mësuesit e mi të kardiologjisë, Gjin Ndrepepa, Adnan Kastrati, Spiro Qirko, Anesti Kondili, Antonio Pezzano, Michael Heinein, etj. M'u pikturuan peizazhet e dashurisë së tyre mistike në shkencën e kardiologjisë dhe profesionin fisnik të kardiologut. Tashmë nuk kisha asnjë dilemë: asnjë kardiolog nuk mund të jetë i suksesshëm pa qenë marrëzisht i dashuruar në zanatin, të cilit ia ka dhuruar jetën. Kishte plotësisht të drejtë dr. Payal që këtë dashuri e quante hyjnore.

### Historia e Kardiologjisë Kosovare- lules së rritur nën hije

Asgjë më shumë nuk u kam lakmuar nikoqirëvë të universiteteve prestigjioze, të cilat kam pasur rastin t'i vizitoja këto dy dekada, se kur më prezantonin fotografitë e mjekëve dhe profesorëve të cilët kishin datat e lindjes së tyre qindra vjeçare, të varura dhe të ruajtura me përkushtim në korridoret e klinikave dhe të auditorëve të tyre. Ato fotografi janë sot dëshmia më e mirë e traditës së një shteti në mjekësi dhe nuk ka asnjë dyshim se janë edhe parakallëzues të rëndësishëm të cilësisë së një universiteti, por edhe të cilësisë së shërbimeve mjekësore të një vendi. Për fat të keq, ne edhe nuk kemi shumë të tregojmë, por edhe ato që kemi disi i fshehim, i gjymtojmë, i politizojmë, e shpesh edhe i personalizojmë. Në fakt, kardiologjia kosovare, që pashmangshëm ka ndjekur fatin e historisë së vuajtur të Kosovës e cila më së voni në Europë e shijoi lirinë dhe ka një histori të shkurtër, shumë të re në moshë.

Mjeku tetovar, Prof. Dr. Jusuf Rexhepi duket të ketë qenë mjeku i parë shqiptar që u mor me kardiologji në Kosovë. Pra, Kosova ka një histori aq të shkurtër kardiologjie, saqë njeriu e parë që është marrë me këtë specialitet unë e kisha parë në vitet 80-ta duke kaluar nëpër oborrin e Fakultetit të Mjekësisë.

**Korrespondenca:**  
ganibajraktari@yahoo.co.uk

“E larguan nga puna, sepse është i papërshtatshëm për pushtetin”, tha dikush për burrin e pashëm, shtatllartë, të veshur me pedantmeri. E kuptova se ishte Jusuf Rexhepi, të cilin e pashë për herë të parë dhe të fundit, ani pse libri i tij i Propedeutikës ishte një nga “fajtorët” e dashurisë simë të pambarim në mjekësi. “Sa e tmerrshme është historia e mjekësisë në Kosovë”, thashë me vete: largohet mjeku sepse nuk është i përshtatshëm, ani pse nuk kishte asnjë dilemë se ishte më i miri. Kjo histori primitive na ka ndjekur edhe pas viteve 90-ta kur pushtuesi i pashembullt ndiqte nga puna edhe mjekët: bënte atë që nuk e kishte bërë as vet Hitleri! Në disa raste kjo praktikë primitive është ndjekur edhe në vitet e demokracisë së pasluftës, fatkeqsisht.

Prof. Dr. Ymer Koçinaj dhe Prof. Dr. Abdylatif Fusha ishin pasuesit e prof. Jusufit, të ndjekur nga Prof. Dr. Faik Hima, Prof. Dr. Masar Gashi dhe Prof. Dr. Ejup Pillana, si dhe mjekët e rinj të asaj kohe Dr. Rexhep Manaj e Dr. Kelmend Pallaska. Kaq ishte Kardiologjia Kosovare kur pushtuesi serb erdhi dhe zaptoi Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë në vitin 1990. Serbët, si gjithnjë, kishin plane të detajuara dhe ogurzeza për çdo gjë që ishte shqiptare, e kardiologjia ishte gjë e rëndësishme për ta. Ata e goditën mu në palcë kardiologjinë; larguan 4 nga gjithsej 7 mjekë që merreshin me kardiologji në Fakultetin e Mjekësisë (me një gurë vranin dy zogj: edhe dobësim të frymës shqiptare në Fakultetin e okupuar, edhe tentim përçarjeje, dhe sollën plot mjekë serbë për ta serbizuar këtë fushë dhe çdo gjë që frymonte shqip. Tentativa e tyre për të punësuar mjekë “shqiptarë” u kishte dështuar, sepse edhe përkundër faktit se plot mjekë shqiptarë ishin të papunë, arritën të gjënin vetëm një “shqiptar” të ndershtëm, siç e quanin, që do të përfaqëonte organin udhëheqës pushtues të asaj kohe.

Ishte Shqipëria ajo që shpëtoi celulën e kardiologjisë kosovare, duke pranuar pa asnjë kusht, e me mikpritjen më të lartë vëllazërore e njerëzore mjekët e rinj kosovarë, Nehat Rexhepajn, Lulzim Kamberin, Nebih Musliun, Shpend Elezin e Gani Bajraktarin, të cilët në vitet më të vështira që po kalonte Kosova, në vitet e pushtimit klasik nga Serbia, me sakrificë mbinjerëzore arritën që të mbarojnë specializimin në Qendrën Spitalore Universitare në Tiranë. Ata u bënë kështu mjekët e parë kosovarë në historinë e Kosovës që kishin mbaruar specializimin nga Kardiologjia. Agimi i lirisë e gjeti Kosovën me më pak se 10 kardiologë, të cilëve pak vite më vonë iu bashkuan edhe Faik Shatri e Hamza Selmani, të specializuar në Tiranë, si dhe Agim Krasniqi, Bekim Mala e Sami Gjoka, të specializuar në Rumani. Me ikjen e pushtuesit, gjërat ndryshuan e bashkë me të edhe pavarësia e kardiologjisë doli nga ombrella e Beogradit, ombrellë e cila për dekada të tëra i kishte zënë rrezet e diellit lules së zemrës, lules së bukur të kardiologjisë, e cila nuk kishte se si të rritej pa e parë kurrë diellin me sy!

### Shoqata e Kardiologëve të Kosovës - një histori sukcesi

Shoqata e Kardiologëve të Kosovës është një lule e bukur, një lul-bozhur i kuq i Kosovës, një lule që u rrit në diell, një lule që shijoi rrezet e diellit nga të katër anët e Europës, është një lule që ka një aromë kaq të mirë, saqë nuk dallon nga ato lulet e bukura të qyteteve franceze (qyteteve të luleve), të paktën ajo është jo më pak e bukur se lulet e Nicës, aty ku është Shtëpia e Zembrës e Shoqatës Europiane të Kardiologjisë (ESC), e ku shoqata jonë nga viti 2009 ka një “dhomë” nga ku shijon barabartë me të gjitha lulet e Europës rrezet e qiellit francez, të pastër dhe plot dashuri. Nuk kam asnjë dilemë se dashuria ime për Shoqatën nuk është aspak më e vogël në gradacion sesa dashuria për kardiologjinë. Dallon vetëm historia e dashurisë: ne u rritëm së bashku dhe nuk e kuptojmë se cili është më i moshuar. Shoqata e Kardiologëve të Kosovës është themeluar më 4 qershor të vitit 2002 dhe kryetar i parë i saj ishte zgjedhur Prof. Dr. Masar Gashi. Pashmangshëm, kur shkruaj këtë datë më dalin përsëri përpara fotografitë e kardiologëve italianë në muret e korridorëve, dhe më del përpara viti 1935 kur ishte formuar Shoqata e Kardiologëve Italianë. Megjithatë, shumë ngjarje, shumë aktivitete shkencore, shumë pjesëmarrje në kongrese ndërkombëtare, shumë miqësi me kolegët vendorë e të huaj, shumë ngjarje sociale, shumë darka gala, kanë ndodhur këto vite nën petkun e kësaj shoqate, saqë nuk ka njeri që mund t'i mbajë mend të gjitha.



Me nostalgji kujtoj dizajnimin e logos së Shoqatës. Është interesant fakti se njeriu që dizajnoi logon e Shoqatës ishte miku im Trimi, një njeri krejt i panjohur për opinionin në atë kohë, i cili një vit më vonë do të dizajnonte Flamurin e Kosovës. Logoja jonë kishte në mes të zemrës hartën e Kosovës. Akoma dhe sot mendoj se nuk ka asnjë mundësi të kemi një logo më të mirë, më të bukur dhe më domethënëse se logoja jonë: një zemër e kuqe, plot dashuri që përfaqon në gjë shtetin e ri Kosovën, e cila akoma nuk ishte shtet!

Kongresi i Parë i Shoqatës është mbajtur në vitin 2008 në Prishtinë, një kongres i paharruar që kishte arritur të sillte në Prishtinë, përveq pothuajse të gjithë profesorëve nga Tirana, edhe emrat më eminent europian të fushës së kardiologjisë, siç ishin Prof. Dr. Fausto Pinto, President i ESC, Prof. Dr. Adnan Kastrati, një nga emrat më të mëdhenj

botëror të kohës në fushën e kardiologjisë invazive, e shumë të tjerë. Ky kongres ishte ditëlindja e dytë e Shoqatës, ishte një konfirmim se kardiologjia kosovare nuk ka të ndalur. Ishte një ngjarje shkencore që edhe vendet e zhvilluara vështirë mund të organizonin.

Në vitin 2009 ndodhi ajo që e kishim vështirë të imagjinonim: pas 3-4 korrespondencave me Presidentin e ESC dhe me shumë miq të tashmë kishim në Bordin e ESC, me sugjerimet e tyre plotësiva kërkesën për anëtarësim në ESC. Kërkesa ishte hedhur në votim dhe, me shumicë votash, shoqata jonë ishte zgjedhur anëtare e barabartë me shoqata të tjera nacionale. Ishte shoqata e parë mjekësore nga Kosova që po pranohej në një forum të tillë europian. Emocionet e ceremonisë së pranimit në Kongresin e ESC në Barcelonë më 1 shtator 2009, të cilat përjetova bashkë me Dr. Xhevat Pllanën, mund të duken absurde për kohën, por ishin të papërshtueshme në momentin kur ato u përjetuan. Rrallë kemi pasur



gëzim më të madh Dr. Xhevati dhe unë! Dhe prej atëherë u hapën të gjitha dyert e prosperimit të shoqatës sonë, e bashkë me të edhe të komunitetit kardiologjik kosovar. Dhjetëra mjekë kosovarë kanë marrë pjesë çdo vit në të gjitha kongreset që organizon ESC, qindra prezantime abstraktesh, dhjetëra punime shkencore të publikuara në revistat e ESC, dhjetëra ligjërata, udhëheqje seancash, pjesëmarrje në grupe punuese, pjesëmarrje e barabartë në regjistrat që organizon ESC, udhërrëfyes të përkthyer, e plot aktivitete të tjera, të cilat vite më parë kanë qenë zor të imagjinueshme, e sot janë realitet.

Shoqata e Kardiologëve të Kosovës sivjet organizon kongresin e 6-të të saj, që do të mbahet më datat 20-21 maj në Prishtinë.

Ajo sot ka 108 anëtarë të rregullt. Në kuadër të Shoqatës veprojnë edhe 5 grupe punuese, të cilat organizojnë aktivitetet e tyre shkencore. Shoqata e Kardiologëve të Kosovës është pa asnjë dyshim një histori sukseesi, është krenaria jonë, është udhërrëfyesi ynë drejt sukseeseve të reja.

